

STATUTI

2016

I

DISPOZITATE PERGJITHSHME

Neni 1.

Ky statut është akti themelor i Levizjës Qytetare “Vatra” me të cilin rregullohen këto fusheveprime:

1. Themelimi dhe pozita juridike e Levizjes Qytetare Vatra,
2. Struktura organizative e Levizjës Qytetare Vatra,
3. Anetaresia dhe 4. Organet e Levizjës Qytetare Vatra .

Neni 2.

2.1. Levizja Qytetare Vatra ka statusin e organizimit politik dhe është lëvizje politike e qytetareve që veprimtarinë programore dhe statutare e zhvillon sipas ligjeve të Republikës së Kosovës,

2.2. Levizja Qytetare Vatra i pranon dhe u përmbahet Konventave Nderkornbetare për të drejtën e popujve për vetvendosje, organizim të lire, pluralizem, pranon parimet themelore të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut.

Neni 3.

3.1 Levizja Qytetare Vatra vepron në mënyrë të pavarur brenda dhe jashtë vendit dhe do të bashkëpunojë me të gjithë ata që kanë për qëllim thellimin e demokracisë e ndjenjën e dashurisë mes njerezve, pavarësisht nga gjuha, feja, kombi dhe ngjyra.

Neni 4

Emri i plotë është: Levizja Qytetare Vatra (LQV)

Neni 5.

Selia e Levizjes eshte ne Gjilan, rr. Sadulla Brestovci nr.16.

Neni 6.

6.1. Levizja Qytetare Vatra, per vertetirnin e autenticitetit te vet ka vulen e rrumbullaket me kete tekst: Levizja Qytetare Vatra me emrin e selise ne mes, e shkruar ne gjuhen shqipe si dhe pamjen e flamurit kornbetar ne meso

6.2. Levizja Qytetare Vatra posedon edhe vulen ne forme katrore, e shkruar ne gjuhen shqipe dhe angleze. me kete tekst:

Levizja Qytetare Vatra

Nr. ----- Data ----- Gjilan.

6.3. Teksti i vulave dhe shenja (simboli) i Levizja Qytetare Vatra mund te ndryshohet me vendim te vecante te anetareve Keshillit Drejtues me shurnice votash.

6.4. Levizja Qytetare Vatra ka edhe emblemen me pamje te flamurit kombetar,

Neni 7

Dokumentet themeltare te Levizjes Qytetare Vatra jane:

7.1. Programi politik i Levizjes Qytetare Vatra dhe

7.2. Statuti I Lëvizjes Qytetare Vatra.

Neni 8

8.1 Levizja Qytetare Vatra mund te deklarohet per probleme te caktuara politike, kornbetare, ekonomike, kulturore, arsimore, shendetesore, shoqerore etj.

Neni 9

9.1 Levizja Qytetare Vatra mund te siguroje mjete financiare nga anetaresia, donatoret, dhuratat, shteti, nga projektet e ndryshme e nga burime te tjera te ligjshme.

Nelli 10.

10.1 Levizja Qytetare Vatra ne veprimtarine e vet eshte e pavarur dhe deklarohet per shprehje dhe veprim te lire.

Neni 11.

11.1 Levizja Qytetare Vatra bashkepunon me institucione, subjekte, shoqata tjera me te cilat ka interes dhe qellime te perbashketa si ate kornbetare dhe nderkombetare, por gjithhere mbi parimin e barazise.

Neni 12.

12.1. Levizja Qytetare Vatra mund te kete edhe media te veta dhe te zhvilloje veprimtari botuese. 12.2. Levizja Qytetare Vatra mund te kornunikoje publikisht per te gjitha problemet shoqerore, ekonomike, shkencore, sociale, artistike etj. Anetaresia

Neni 13

Anetare i Levizjes Qytetare Vatra mund te behet cdo qytetare i Republikes se Kosoves, pa dallim gjinie, gjuhe, race, kornbesie, religjioni, aftesi fizike etj., i (e) cili duhet t'i kete mbi 18 vjet.

13.1. Anetaret e Levizjes Qytetare Vatra veprimtarine e vet politike, profesionale, humanitare etj, e zhvillojne brenda Levizjes Qytetare Vatra.

13.2. Anetari i Levizjes Qytetare Vatra ka te drejte te zgjedh dhe te zgjidhet ne organet e Levizjes Qytetare Vatra, ka te drejte te shpreh mendimin ne gjuhen e vet.

13.3. Anetari i Levizjes Qytetare Vatra behet duke u regjistruar si anetare i Levizjes Qytetare Vatra ne deget ose ne nendeget e saj.

13.4. Ndersa shkarkohet me vendim te Kryesise Qendrore ose me shumice votash nga kryesia e deges, kur ben shkelje te Statu tit si dhe nuk respekton program in, rregulloren dhe vendimet e Levizjes Qytetare Vatra.

13.5. Kunder vendimit per largim anetari ka te drejte ankese ne Keshillin Drejtues ne afat prej 7 (shtate) ditesh, 13.6. Keshilli Drejtues shqyrton ankesen ne mbledhjen e pare dhe vendos lidhur me ankesen e anetarit te larguar,

13.7. Anetare nderi mund te behet ndonje personalitet i shquar i ceshtjes kombetare dhe nderkornbetare qe eshte deshmuar ne veprimtarine e tij.

13.8. Cdo anetare paguan anetaresi vjetore ne vlere prej 12(euro) €. Per lirimin nga pagesa vend os Kryesia e Levizjes Qytetare Vatra. Procedura per ndryshimin e Statu tit

Neni 14

14.1 Ndryshimi dhe plotesimi i ketij statuti behet me procedure te rregullt. Propozimi per ndryshimin e tij mund ta bejne Kryesia Qendrore, Keshilli Drejtues ose 1/3 e anetareve te Kuvendit te Levizjes Qytetare Vatra. 14.2. Po ashtu ndryshimi dhe plotesimi i programit politik behet ne procedure te njejte sikurse ndryshimi i Statutit ne perputhje me Ligjet ne fuqi te Republikes se Kosoves, Koalicionet Elektorale

Neni 15

15.1 Kryesia e Levizjes Qytetare Vatra udheheq bisedimet per koalicion para dhe pas zgjedhor dhe propozon per miratim Keshillit Drejtues. 15.2. Keshilli drejtues miraton mmarveshjen e koalicionit para dhe pas zgjedhor me shumice te thjeshte votash. Kryetari i Levizjes Qytetare Vatra

Neni 16

16.1 Kandidat per kryetar mund te behet cdo anetare i Levizjes Qytetare Vatra duke kaluar procedurat zgjedhore ne Kuvend.

16.2. Kryetari zgjidhet me shumice votash te fshehta ose me marreveshje me vota te hapura nga Kuvendi zgjedhorë.

16.3. Procedura per shkarkimin e kryetarit eshte e njejte sikurse zgjedhja e kryetarit.

16.4. Kryetari shkarkohet edhe kur ben shkelje te Statutit si dhe nuk respekton program in, rregulloren dhe vendimet e Levizjes Qytetare Vatra.

16.5. Kryetari i Levizjes Qytetare Vatra mundet ne cdo kohe te jap doreheqje nga detyra e tij si kryetar per arsye shendetesore ose arsyet tjera personale te tij. Organet e Levizjes Qytetare Vatra

Neni 17

17.1 Organet e Levizjes Qytetare Vatra jane: Kuvendi, Keshilli Drejtues, Kryesia Qendrore, Komisioni mbikeqyres, Komisioni Statutar Forumi i Gruas, Forumi Rinor dhe Komisioni Financiar.

17.2. Te drejtat dhe obligimet e organeve percaktohen me Statut, me rregullore te punes se Kryesise dhe me vendime e rregullore te vecanta te miratuara ne Kuvend.

17.3. Kuvendi perbehet nga **51 delegate**

17.4. Kuvendi i rregullt mbahet cdo kater (4) vjet.

17.5 .Kuvendin e therret Kryetari, Keshilli Drejtues ose Kryesia

17.6. Thirrjen e Kuvendit mund ta kerkojne edhe 1-3 e anetareve te Keshillit Drejtues.

17.7. Punimet e Kuvendit i drejton anetari me vjeter dhe me i riu se bashku edhe me tre anetare te tjere te keshillit iniciues, ne te ardhmen Kryetari i Levizjes.

17.8. Ne punimet e Kuvendit marrin pjese si delegate edhe aneta ret e deritashem te Keshillit Nismetar,

17.9. Kuvendi miraton ndryshimin, plotesimin e programit dhe statutit, miraton rregulloret e punes se Kuvendit, planet financiare dhe llogarite perfundimtare.

Keshilli Drejtues

Neni 18

8.1 Keshilli drejtues eshte organi me i larte ne mes dy(2) kuvendeve.

18.1. Te gjithë delegatet e Kuvendit zgjedhin 26 anetare te Keshillit Drejtues.

18.2. Keshilli Drejtues perbehet nga anetaret e Kryesise, Komisioni Mbikeqyres, Komisioni Financiar, Komisioni Statutar dhe nga kryetaret e degeve.

18.3. Keshillin Drejtues e udheheq Kryetari i Levizjes Qytetare Vatra.

- 18.4. Keshilli Drejtues thirret ne cdo 6 (gjashte) muaj e sipas nevojës edhe me shpesh.
- 18.5. Keshillin Drejtues e thërret Kryetari, Kryesia sipas nevojës ose me teper se 1-3 e Kryetareve te degeve.
- 18.6. Kryesia e Keshillit Drejtues i pergjigjet Kuvendit te Levizjes Qytetare Vatra.
- 18.7. Keshilli Drejtues bashkerendit veprimtarine e degeve te Levizjes Qytetare Vatra, angazhohet per sendertimin e Programit te Levizjes Qytetare Vatra, kontrollon punen e Kryesise dhe organ eve tjera mes dy (2) Kuvendeve.
- 18.8. Keshilli Drejtues zgjidhet me vota te fshehta apo me marreveshje me aklamacion me propozim te Komisionit kandidues dhe te anetareve te Kuvendit.

Kryesia

Neni 19

- 19.1 Kryesia eshte organ drejtues i Levizjes Qytetare Vatra. Per punen e saj Kryesia i pergjigjet Keshillit Drejtues.
- 19.2. Anetaret e Kryesise i zgjedh Keshilli Drejtues me shumice votash, 15 me te votuarit.
- 19.3 Kryetarja e Forumit te Gruas dhe Kryetari i Forumit Rinor ne menyre automatike jane anetare te Kryesise se Levizjes Qytetare Vatra.
- 19.4 Kryesia perbehet nga 17 anetare (duke perfshire edhe 2 kryetaret e forumeve).
- 19.5 Kryesia nga perberja e saj zgjedh Kryetarin, dy Nenkryetare, Sekretaret, Arketarin me dy anetare dhe Pergjegjesin e Sektorit per Informim me dy (2) anetare, qe njekohesisht jane edhe anetare te Kryesise se Levizjes.
- 19.6 Kryesia drejton dhe udheheq veprimtarine e Levizjes Qytetare Vatra.
- 19.7. Zbaton programin, Statutin dhe vendimet e Keshillit Drejtues.
- 19.8 Harton projekte e dokumente tjera dhe propozon miratimin e tyre ne Keshillin Drejtues,
- 19.9 Pergatit planet financiare, raportin e punes dhe raportin financiar te cilin ia paraqet Kuvendit per miratim. 19.10. Harmonizon dhe koordinon bashkepunimin me organizatat politike, humanitare, kulturore dhe gjithe te interesuarit per bashkepunim me Levizjen Qytetare Vatra.
- 19.11. Vendos per aderim ne asociacionet tjera kombetare dhe nderkombetare dhe bashkepunimin me to. 19.12 Cakton veprimtarine dhe punen e seksioneve duke e marre mendimin e tyre. 19.13 Miraton rregullore per shpenzime te mjeteve financiare dhe vendosjen per shperndarjen e tyre sipas nevojës.

Kandidatet per Kuvendin Komunal dhe ate Qendror

Neni 20

20.1 Kandidatet per Keshilltare Kornunal dhe ate Qendror propozohen nga Kryesia ne bashkepunim me deget dhe nendegjet e Levizjes Qytetare Vatra, dhe propozon miratimin e tyre nga Keshilli Drejtues, ne pajtim me Ligjin ne fuqi per zgjedhjet te Republikes se Kosoves.

Kontrolli i Brendshem Financiar

Neni 21

21.1 Levizja Qytetare Vatra si organ te vetin ka edhe Komisionin Financiar i cili ben kontrollin e brendshem financiar.

22.2. Komisioni Financiar ka Kryetarin dhe 2 (dy) anetare te tjere,

22.3. Komisioni Financiar' kontrollon dokumentacionin Financiar', mbikeqyr rregullsine e shperndarjes se mjeteve dhe te shpenzimeve te Levizjes Qytetare Vatra, si dhe te hyrat nga donacionet.

22.4. Ky komision i raporton Kryesise se Levizjes Qytetare Vatra, Keshillit Drejtues dhe publikon ne Faqen zyrtare te Levizjes raportin e saj financiar. Komisioni Statutar

Neni 22 22.1 Levizja Qytetare Vatra si organ te vetin ka edhe Komisionin Statutar i cili ka kompetence zgjidhjen e kontesteve lidhur me interpretimin e Statutit.

22.2. Komisioni Statutar ka Kryetarin dhe 2 (dy) anetare.

22.3 Komisioni Statutar kujdeset per harmonizimin e akteve normative dhe te vendimeve te Levizjes Qytetare Vatra, me dispozitat statutore.

22.4. Kontrollon zbatimin e akteve normative te Levizjes Qytetare Vatra dhe konstaton shkeljet eventuale te tyre, per cka e njofton Kryesin dhe Keshillin Drejtues.

22.5. Per cdo leshim, shkelje apo keqperdorim te kompetencave dhe te dispozitave juridike te Levizjes Qytetare Vatra, Komisioni Statutar me kohe i njofton organet dhe kerkon marrjen e masave perkatese.

Shuarja e Levizjes Qytetare Vatra

Neni 23

23.1 Vendimin per nderprerjen e punes, shuarjen apo shperndarjen e Levizjes Qytetare Vatra e merr Kuvendi me vota te se paku 3/4 e te pranishrneve dhe ne pajtim me Rregulloren e Levizjes Qytetare Vatra. 23.2. Per mjetet qe disponon Levizja Qytetare Vatra ate moment (para, orendi, mjete pune etj), vend os Kuvendi se bashku me Komisionin Financiar.

23.3 Ne rast te shuarjes te Levizjes Qytetare Vatra, Komisioni Financiar' eshte i obliguar qe borxhet eventuale te Levizjes ti mbulon me orendite ekzistuese si: kompjuteret, tavolina, kariket, tv, etj. Ndersa pasuria e mbetur me vendim te komisionit financiar mund te dhurohen donacion ndonje OJQ-se

Neni 24

24.1 Levizja Qytetare Vatra ka edhe xhirollogarine e vet ne 1(; ellen i deponon te hyrat financiare . 24.2. Kete xhirollogari e mbikeqyre Kryetari i Levizjes Qytetare Vatra dhe Arketari i Levizjes. Dispozitat Kalimtare dhe tt;

Neni 25.

1 Statuti behet i plotfuqishern nga dita e miratimit 1(; tij ne Kuvendin e Pergj ithshern,

25.2. Interpretimin dhe komentimin e ketij Statuti e bene Komisioni Statutar.

Gjilan, 2016 ~ LEVIZJA QYTETRE VATRA